

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-094/14**

Prishtinë,  
16 Dhjetor 2015

Në çështjen juridike të:

D. H. U.

**Pala ankuese**

kundër

V.M.

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Anders Cedhagen, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/192/2013 i datës 13 shkurt 2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin 13176), pas shqyrtimit të mbajtur më 16 Dhjetor 2015, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

1. Ankesat e paraqitura nga D. U., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-094/2014 dhe GSK-KPA-A-101/2014 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-094/2014.
2. Hidhen poshtë si te papranueshme ankesat e D. U., e paraqitura kundër vendimit të Komisioni për Kërkesat Pronësore te Kosovës KPCC/D/C/192/2013 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare te Pronës me numrin 13176), i datës 13 shkurt 2013.

**Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 2 gusht 2006, V. M. (në tekstin e mëtutjeshëm: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur dy kërkesa të ndara në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e lokalit afarist (dyqan) me 130 m<sup>2</sup> që ndodhet në ngastrën urbane me pronësi shoqërore 3416/1, me adresë, Patrijarsijska nr.1, në Pejë (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar). Kërkesat janë regjistruar në AKP me numrat KPA13176 dhe KPA44318.
2. Për të mbështetur kërkesat e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
  - Lejen e ndërtimit nr. 01-351/2377 të lëshuar më 11 korrik 1997 nga Komuna e Pejës.
  - Vendimin administrativ nr.001-351/2377, të lëshuar më 28 gusht 1997 nga Komuna e Pejës.
  - Vendimin për ndarjen nr.01-353-1212/98 të lëshuar më 25 gusht 1998 nga Komuna e Pejës.
  - Vendimin administrativ nr.03-351/2439 të lëshuar më 25 gusht 1999 nga Komuna e Pejës.
  - Vendimin administrativ nr.06-313/1958 të lëshuar më 30 korrik 1987 nga Komuna e Pejës
  - Librezën për tatime nr.45005
3. Të gjitha dokumentet e mësipërme janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
4. AKP-ja e ka siguruar ex officio, një pjesë të fletës poseduese nr.2606, date 30 Janar 2007, ku figuron Komuna e Pejës si pronare e ngastrës nr. 3416/1.
5. Kërkesa u njoftua në 22 tetor 2010. Ekipi i AKP-së e kishte vizituar pronën më 1 Nëntor 2010 dhe më 8 Nëntor 2010. Gjatë vizitës së fundit prona ishte gjetur e uzurpuar nga Nj.B., i cili ka kërkuar të drejtat ligjore ndaj pronës por nuk e ka nënshkruar Njoftimin për

pjesëmarrje, nuk ka dorëzuar asnjë provë që dëshmon të drejtat e tij pronësore dhe se nuk ka marrë pjesë në procedurë para Komisionit për Kërkesat Pronësore të Kosovës (KKPK).

6. KKPK-ja e ka miratuar kërkesat me vendimin KPPC/D/C/192/2013, të datës 13 shkurt 2013.
7. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 05 korrik 2013 kurse më 27 janar 2014 D. U., i cili është gjet se e uzurponte pronën e kërkuar. Më 14 shkurt 2014 D. U. (në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese) ka paraqitur ankesë kundër Vendimit KPPC/D/C/192/2013, të datës 13 shkurt 2013 në lidhje me kërkesat KPA13176 dhe KPA44318.
8. Ankesat i janë dorëzuar V. M. (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë) më 04 korrik 2014 dhe ai e ka paraqitur përgjigjen e tij më 30 korrik 2014.

### **Pretendimet e palëve:**

9. Pala ankuese pohon se prona e kërkuar nuk është e ndërtuar në ngastrën 3416/1 por në ngastrën 2256 ZK në Pejë, e cila është në posedim dhe pronësi të tij. Me ankesë ai thirret në vërtetimin e gabuar të fakteve dhe kërkon që vendimi i ankimuar të pezullohet.
10. Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se ankesat janë të papranueshme sepse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurë para KKPK-së. Ai po ashtu pretendon se ngastra e përmendur në ankesë është krejtësisht tjetër dhe ndodhet përballë pronës së kërkuar. Ai kërkon nga Kolegji i Ankesave të AKP-se ta hedhë poshtë ankesën si të papranueshme apo ta refuzojë të njëjtën si të pabazuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

#### **Bashkimi i ankesave**

11. Sipas nenit 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale e ndryshuar me Ligj Nr.03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore e UNMIK 2006/50), Gjykata Supreme mund të vendosë për bashkimin apo shkrirjen e ankesave kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në përputhje me nenin 11.3 (a) të Ligjit. Ky nen i mundëson Komisionit të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave për të shqyrtuar lëndën dhe marrë vendime kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

12. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile që aplikohen në procedurat para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Rregullores se UNMIK-ut 2006/50, si dhe me dispozitën e nenit 408.1 e lidhur me nenin 193 të Ligjit nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore (ne tekstin e mëtejme: LPK), ofrojnë mundësinë e bashkimit të gjitha kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efektivitetin e gjykatës dhe efikasitetin e lëndës.
13. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme thekson se përveç numrit të ndryshëm të kërkesave për të cilin është paraqitur ankesa përkatëse, faktet, baza ligjore dhe çështjet e provave janë krejtësisht të njëjta në të dy kërkesat. Ankesat mbështeten në deklaratën e njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Gjithashtu, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjti.
14. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-094/2014 deri GSK-KPA-A-101/2014 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-094/2014.

### **Pranueshmëria e ankesës**

15. Ankesat janë të papranueshme sepse ato janë paraqitur nga një person i cili nuk ishte palë në procedurë në shkallë të parë pranë KKPK-së.
16. Sipas nenit 12.1 të Rregullores se UNMIK 2006/50, para mund të paraqes ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga AKP lidhur me vendimin e KKPK-se për kërkesën.
17. Neni 10.1 i Rregullores se UNMIK 2006/50 parashih që pas pranimit të kërkesës, sekretaria ekzekutive e AKP-së do ta njoftojë dhe do t'ia dërgojë një kopje të ankesës çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës. Neni 10.2 i se njëjtës rregullore thekson se *“çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë do të jetë palë e kërkesës... me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive [...]”*.
18. Vetëm një palë në procedurën në shkallë të parë ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Sipas praktikës gjyqësore të Kolegjit të Ankesave të AKP-së të Gjykatës Supreme, vet përjashtimi i këtij rregulli del në pah nëse dhe kur personi i interesuar i cili e pretendon të drejtën ndaj pronës së kontestuar, nuk ka pasur dijeni dhe nuk ka

mundur të ketë pasur dijeni për kërkesën e paraqitur në AKP shkaku i mungesës së njoftimit të duhur mbi kërkesën dhe kështu nuk ka mundur të paraqesë njoftimin për pjesëmarrje gjatë rrjedhës së procedurës në shkallë të parë.

19. Për lëndën në fjalë, Gjykata Supreme vëren se pala ankuese ishte në dijeni rreth procedurës në lëndën nr. KPA13176, pasi që njoftimi i kërkesës është bërë siç duhet në bazë të ligjit. Një person tjetër- Nj. B. i ka kërkuar të drejtat ligjore ndaj pronës së kërkuar, por nuk e ka paraqitur njoftimin për pjesëmarrje siç kërkohet me nenin 10.2 të Rregullores se UNMIK 2006/50.
20. Megjithatë, Gjykata Supreme e gjen si të dobishme të përmend se çështja lëndore e kërkesës në lëndën nr. KPA13176, e vendosur me vendimin e ankimuar nr. KPPC/D/C/192/2013 të datës 13 shkurt 2013, ka të bëjë me lokalin afarist (dyqanin) me 130 m<sup>2</sup>, që ndodhet në ngastrën urbane në pronësi shoqërore 3416/1, me adresë, Patrijarsijska nr.1, në Pejë, e jo për ngastrën 2256ZK. Në këtë drejtim nuk ka asnjë interes ligjor për palën ankuese që ta kundërshtojë vendimin e lartpërmendur të KKPK-së.
21. Ankesat duhet të hidhen poshtë si të papranueshme në pajtim me nenin 12.1 dhe 13.3 (b) të Rregullores se UNMIK 2006/50 dhe nenin 195.1 nën-paragrafi (a) të LPK. Prandaj, Kolegji i Apelit të AKP-së vendosi si në dispozitiv.

### **Këshillë ligjore**

22. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**